



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1139 Prot.

Tiranë, më datë 24.08.2023

VENDIM  
Nr. 456, datë 24.08.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.08.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të potencialit arkeologjik në kuadër të projektit “Godinë banimi shërbimi dhe hotelerie 6,13,20,27,34 dhe 41 dhe 5 kate parkimi nëntokë, me Nr.Pasurie 3/67/ND, Zona Kadastrale 8210, rruga “Muhamed Gjollësja”, Njësia Administrative 7, Bashkia Tiranë” me aplikues Silvana Kita dhe zhvillues “Develalb Construction sh.p.k & "Edonil Konstruksion" sh.p.k;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3-palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Godinë banimi shërbimi dhe hotelerie 6,13,20,27,34 dhe 41 dhe 5 kate parkimi nëntokë, me Nr.Pasurie 3/67/ND, Zona Kadastrale 8210”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 145 - 147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Elva MARGARITI

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

Klesta  
Qirici

Digitally signed by  
Klesta Qirici  
Date: 2023.08.25  
13:30:45 +02'00'

Elva  
Margariti

Digitally signed by Elva  
Margariti  
Date: 2023.08.25  
13:40:16 +02'00'